



Përmbledhje e LASLP

Ligji mbi Ndhimat Shoqërore dhe Luftën kundër varfërisë (LASLP) do të hyjë në fuqi më 1 janar 2025. Ky ligj ofron mbështetje që fokusohet në integrimin shoqëror dhe profesional të njerëzve që ndodhen përkohësisht në një situatë të vështirë.

- Ndhima shoqërore është një e drejtë dhe mundësi i saj është thjeshtuar me një minimum kërkesash administrative.
- Ndhima shoqërore e ofruar nga Hospice général bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës që mundëson hartimin e një plani të ndërtuar për të përmbushur nevojat tuaja specifike (strehimin, shëndetin, trajnimin, punën etj.).
- Një mbështetje e veçantë u jepet të rinjve, familjeve dhe fëmijëve.

Integrim më i lehtë

Anëtarët e stafit të Hospice général ju mbështesin teksa riktheheni në pavarësinë tuaj dhe ju ofrojnë:

- aktivitete që synojnë mbajtjen dhe forcimin e lidhjeve shoqërore;
- një vlerësim të aftësive dhe udhëzime për karrierën;
- kurse afatshkurtra dhe afatgjata;
- praktikë në biznese për t'ju mundësuar të fitoni aftësi të reja.

Nxitje drejt punësimit

Është e rëndësishme që të përfitoni plotësisht nga çdo mundësi profesionale që paraqitet, pasi do t'ju mundësojë të mbani punësimin dhe të zgjeroni rrjetin tuaj.

Kur punoni, qoftë edhe me kohë të pjesshme, një pjesë e pagës suaj nuk zbritet nga asistenca juaj financiare dhe si rrjedhojë, të ardhurat tuaja mujore rriten.

300 frangat e para që fitoni do të jenë tuajat dhe do të mbani gjithashtu 15% të bilancit të rrogës suaj.

Shuma fikse për më shumë autonomi në menaxhimin e buxhetit tuaj

Këto shuma fikse që menaxhoni sipas nevojave dhe dëshirave tuaja, ju paguhen çdo muaj.

- **Shuma fikse bazë** mbulon nevojat tuaja ditore dhe ato të familjes suaj (ushqimi, rrobat, telefoni, elektriciteti, aktivitete argëtuese, udhëtimi etj.), shpenzimet tuaja administrative dhe aktivitetet që lidhen me integrimin tuaj shoqëror dhe profesional.
- **Shuma fikse për fëmijët** synon të mbulojë shpenzime specifike që lidhen me nevojat e fëmijëve tuaj (mbështetje akademike, aktivitete argëtuese, aktivitete jashtëskollore etj.).

Kosto të tjera, si shpenzimet e qirasë dhe ato të kujdesit shëndetësor, paguhen nga Hospice général në bazë të shpenzimeve tuaja, me kushtet e mëposhtme.

Lehtësim në aspektin administrativ

Shuma fikse mujore e pagueshme zakonisht përllogaritet zakonisht çdo 6 muaj. Nëse situata juaj ndryshon, duhet të na e thoni menjëherë. Hospice général nuk ju kërkon zakonisht dokumentet tuaja administrative dhe financiare; kjo u mundëson individëve përkatës që të përqendrohen në planin e tyre të integritit shoqëror dhe profesional.

Për më shumë detaje, vizitoni laslp.hospicegeneral.ch

